

Center for School Leadership

**Moduli: ZHVILLIMI I VIZIONIT DHE I
STRATEGJISË PËR PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS
DHE MENAXHIMIT TË NDRYSHIMIT**

Data 23.12.2019

Seanca VII

VIZIONI – STRATEGJI - PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS

Mirëdita



Bazat për drejtimin e shkollës

- *Drejtimi i suksesshëm i shkollës*
- *Të kuptojmë kontekstin*
- *Grupet e interesit*
- *Kultura e shkollës*
- *Përvojat profesionale të drejtimit dhe përmirësimin të nxënësve*





Dimensioni 1A

Dimensioni 1B

Dimensioni 1C

Dimensioni 1D

Dimensioni 1E

Dimensioni 5A



STRATEGJI - VIZIONI - PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS

- **Dimensioni 1D:** Zhvillimi nëpërmjet krijimtarisë, risive dhe teknologjisë
- **Dimensioni 1E:** Sigurimi i cilësisë dhe rishikimi i strategjive
- **Dimension 4E:** Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm mjedisor, zhvillimi i burimeve njerëzore dhe i bazës materiale të institucionit

Objektivat e Sesionit

- Të kuptojmë elementët e vlerësimit (vetë) të shkollës
- Të jemi në gjendje të shpjegojmë arsyet, synimin dhe qëllimet e **zhvillimit strategjik të shkollës**
- Të kuptojmë rolin e këshillit/ekipeve drejtues të shkollës në planifikimin e zhvillimit të shkollës
- Të kuptojmë dhe çmojmë rëndësinë e **hapave** të përgatitjes të zhvillimit strategjik (planeve #)
- Të jemi në gjendje **të udhëheqim** të tjerët përgjatë hapave të përgatitjes të zhvillimit strategjik (planeve #)
- Të jemi në gjendje të identifikojnë dhe diskutojnë me **grupet e interesit** (të gjitha palët) rreth cilësisë së shkollës

Strategjia për përmirësimin e cilësisë përfshin përcaktimin e aktorëve kryesorë të përfshirë në zhvillimin e shkollës

Përfshirjen e tyre në hartimin e vizionit (*hapi i parë është përcaktimi i vizionit dhe vlerave të shkollës*)

Objektivat për ndryshim në shkollë (*shpjegimin e domethënies së vizionit dhe të synimeve duke përshkruar se si do të ndryshojë shkolla*)

Rezultatet konkrete që do të dëshmojnë përmbushjen e vizionit të shkollës.

VIZIONI – STRATEGJI - PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS

- Formulimi i vizionit të shkollës. Deklarata e vizionit i përgjigjet pyetjes, “Si dëshironi të bëhet shkolla juaj?”
(Hapi i parë në këtë proces)
- Nëse nuk ekziston vizioni me synimet përcjellëse, vlerësimi apo edhe përmirësimi i shkollës është i pakuptimtë dhe jo i organizuar.
- Nëse i futemi një procesi vlerësimi me cilido nga palët e interesit, jashtë vizionit, rezultati: ç’organizim, frustrim, humbje e ndjenjës së përkatësusë
- Devijimi nga vizioni rrezik për humbjen e motivimit nga ana e stafit (shkolla mund të ketë vizion, por ka humb lidhjen me synimet, kriteret e angazhimin e grupeve të interesit)

VIZIONI – STRATEGJI - PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS

- Vizioni është i veçantë për secilën shkollë
- Vizioni varet nga konteksti i shkollës, i mësuesve, nxënësve dhe drejtorit të shkollës
- Për formulimin e vizionit duhet dialog (reference normat ligjore dhe pritshmëritë e fëmijëve dhe komunitetit) dhe punë në ekip
- Vizioni është zemra e një plani strategjik të shkollës
- Vizioni përfaqëson orientimin filozofik të shkollës, parimet dhe vlerat e saj.

Modele vizioni

- *Shoqëri e dijes, e integruar në rrjedha evropiane me mundësi të barabarta për zhvillim personal të të gjithë individëve, të cilit i kontribuojnë zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror.*
- *Ndërtimi i një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, që siguron kushte për formim cilësor të të gjithë individëve duke kultivuar shprehi të të nxëniet gjatë gjithë jetës dhe vlera të qytetarisë demokratike*
- *Zhvillim i plotë i të gjithë nxënësve të shkollës në harmoni me vlerat e arsimit gjithëpërfshirës dhe kërkesat e shoqërisë së përparuar dhe demokratike.*
- *Ofrimi i kushteve për arsimim cilësor tek të gjithë nxënësit përmes kultivimit të shprehive të të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe vlerave të qytetarisë demokratike.*

Extrakte nga vizione shkollë

- “Jemi shkolla e së nesërme, vendi që fuqizon të gjithë në mendje, trup dhe shpirt, jemi shkolla që mëson dhe shëron.
- Shkolla jonë është një vend që bashkon, ndërton ura dhe e sheh larminë si pasuri (kultura, brezat, aftësitë e gjinitë) dhe ku të mësuarit mund të përjetohet si takim për ndarjen e diturive, në një frymë nderimi dhe kureshtjeje.
- Shkolla jonë është një “sistem i hapur” në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin dhe rajonin e saj ku prindërit janë mësimitdhënës dhe nxënës.
- Shkolla jonë do t’u shërbejë njerëzve pas 1-99 + vjetësh sepse ajo udhëhiqet nga njerëz që kanë aftësi dhe zemër për të rritur cilësinë dhe për të shtuar gëzimin që fëmijët tanë duhet të mbajnë në jetë.
- Shkolla jonë, vend i mësimitdhënies dhe të nxënies e cila përmirësohet në mënyrë aktive nga të gjitha palët për të qenë pikëtakimi i diturisë, respektit, krijmtarisë dhe suksesit”.

Shkolla: Vizion – Realitet - Vlera



Diskutim në Grup

Grupi 1: Çfarë lloj shkolle dëshirojmë të krijojmë?

Grupi 2: Çfarë cilësish do të ketë ajo? •

Grupi 3: Si duket shkolla e ëndrrave tona?

Grupi 4: Në çfarë shkolle do të dëshironit të drejtonit ?

Grupi 5: Si do të donim të sillen grupet e tjerë të interesit për të na mundësuar të realizojmë ëndrrat tona?

Vizion – Realitet - Vlera

Vizioni

- një lloj ‘fushe e fuqisë’, me besime të përbashkëta, që i ‘tërheq’ njerëzit të punojnë së bashku.

Realitet

- Forca e vizionit është që të shndërrojë ëndrrat në realitet, ndërsa nga realiteti të nxjerrë ëndrra të tjera

Vlerat

- Vizioni ofron një drejtim ndërsa vlerat shërbejnë si ‘busull’ morale e cila mundëson sjellje të përshtatshme



Planifiko

- Zhvillimi i të nxënit

Vlerëso

- Menaxhimi i burimeve

Veuro

- Zhvillimi organizativ

Nisja e procesit për hartimin e planit strategjik të shkollës

- Ku jemi tani?
- Çfarë duhet të arrijmë?
- Çfarë vizioni kemi? ku duam të jemi pas 5 apo 10 vjetësh? •
- Çfarë synime kemi për të përmbushur vizionin?
- Cilët prej tyre janë afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër?
- Cilat janë burimet dhe bazat mbi të cilat fillojmë? •
- Çfarë duam të ndryshojmë? Çfarë mund të ndryshojmë?
- Çfarë na duhet për të mundur të bëjmë këto ndryshime? Kur/ku duhet të bëjmë ndryshime?
- Si duhet t'i realizojmë ndryshimet?
- Sa është kostoja? Ku mund të gjejmë fondet e nevojshme?
- Cilët njerëz/grupe duhet të angazhojmë?
- Si mund të sigurojmë mbështetje shtesë? •
- Kush do të jetë përgjegjës?
- Si do të monitorojmë dhe vlerësojmë ndryshimet e bëra?

Si t'i dallojmë?

Drejtimi

- Gjetja e rrugës

Menaxhimi

- Ndjekja e rrugës

Administrimi

- Organizimi i rrugës

John ëest Burnham

Drejtimit vs Menaxhimit

- ❖ Drejtimit dhe menaxhimit janë dy sisteme të ndryshme veprimi por plotësuese të njëra-tjetrës në çdo organizatë.
- ❖ Drejtimit ka të bëjë me përballimin e ndryshimit, kurse menaxhimit me përballimin e kompleksitetit. J. Kotter (1990) HBS
- ❖ Menaxhimi do të thotë t'i bësh gjërat drejt, Drejtimit do të thotë të bësh gjërat e duhura. P. Druker, (2006)

Drejtimit vs Menaxhim

- ❖ Drejtimi efektiv është vendosja e prioritetit për gjërat që janë prioritare. Menaxhimi efektiv është disiplinë, realizim i tij (drejtimit). S. Covey (2004)
- ❖ Menaxhimi përbëhet nga zbatimi i vizionit dhe drejtimit që jepet nga drejtuesit, koordinimi dhe plotësimi me staf i organizatës si dhe trajtimi i problemeve të përditshme. R. House (1997)
- **“Managers light a fire under people. Leaders light a fire in people.”**

Vizion – Realitet - Vlera

Drejtimi i shkollës

- ✓ proces menaxhimi
- ✓ proces komunikimi dhe angazhimi
- ✓ process drejt një qasje rreth vizionit/misionit (synimeve) të shkollës dhe filozofisë së zhvillimit të shkollës.
- ✓ Proces për të kuptuar dhe zbatuar vlerat përgjatë çdo veprimtarie/procesi

Nisja e procesit për hartimin e planit strategjik të shkollës



Fillimi i procesit - Planifikimi – Realizimi – Vlerësimi

Hartimi i planit strategjik të shkollës

- Ku qëndron shkolla jonë përsa i përket infrastrukturës, stafit të shkollës dhe nxënësve?
- Çfarë kulture dhe komunikimi ekziston ndërmjet grupeve të ndryshëm të shkollës?
- Si mund të mblidhen të dhëna të saktë për shkollën?

Pyetje: *Si do ta përcaktonit rolin i drejtorit të shkollës në këtë drejtim?*

VIZIONI – STRATEGJI - PËRMIRËSIMIN E SHKOLLËS

- **Standardet** – Niveli i cilësisë së punës së dëshiruar apo pritshmëritë
- **Vizioni** – Deklarata që përshkruan gjendjen që dëshiron të arrijë shkolla; besimet e përbashkëta dhe shërben për të orientuar veprimet e shkollës.
- **Plani strategjik i shkollës** – Vendimet rreth asaj që duhet bërë në të ardhmen; në aspekte të shkollës që grupet e interesit të saj duan të përmirësojnë.
- **Plani vjetor i shkollës** – Veprimtaritë që do të mundësojnë përmbushjen e objektivave të caktuara gjatë një viti shkollor.
- **Treguesit e cilësisë** – rezultatet që tregojnë si është gjendja krahasuar cilësisë së dëshiruar të rezultateve.
- **Vëzhgimi/monitorimi/mentorimi**– Proces/e për të vërejtur, ndryshuar e përmirësuar veprimtaritë e shkollës

Modeli i Drejtimit të Shkollës

- ✓ Proces i organizuar që përdoret për të planifikuar përmirësimin e një shkolle
- ✓ Fillon me formulimin e vizionit; përcaktimin e ekipeve

Bazohet në pyetje si:

- Çfarë dëshiron të arrijë shkolla brenda një periudhe të caktuar.
 - Ku duam të arrijmë?
 - Cilat vlera kanë rëndësi për ne?
 - Çfarë ndryshimesh duhet të bëjmë në praktikën e mësimdhënies? Pse? Si mund ta bëjmë këtë?
 - Si duam që nxënësit tanë të ndërveprojnë, mësojnë dhe krijojnë së bashku?
- Platformë udhëzuese drejt zhvillimit të shkollës.**



Great

LEADERS

don't tell you what to do,

they **SHOW** you

how it's done.

Gëzuar 2020 !

